

- AIDSSH njoftoi të gjithë të interesuarit të plotësojnë formularët e kërkesës për informim, konform ligjit 45/2015 për t'i lexuar këto dokumente.
- Materialet u ekspozuan edhe në Tepelenë, më 23 gusht 2018, në kuadër të organizimeve të AIDSSH me partnerët për Ditën Europiane të Përkujtimit të Viktimave të Sistemeve Totalitare, me praninë e komunitetit vendas. Ekspozita synonte inkurajimin e dialogut lokal mbi të shkuarën, me fokus ngjarje të spikatura të zonës, që i ridimensionojnë figurat dhe nxisin reflektim.
- Në 23 gusht 2018, AIDSSH, si institucion shtetëror përgjegjës për mbështetjen e kërkimit shkencor, gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Bashkinë e Tepelenës, të mbijetuar, institucione dhe shoqëri civile aktive dhe partnerët ndërkombëtarë, në kuadrin e memories organizoi Ditën Muze/Memoriali Tepelenë, në Ditën Europiane të Përkujtimit të Viktimave të Sistemeve Totalitare.
- Në kuadër të Ditës Muze u kryen një shumëllojshmëri aktivitetesh, si: ekspozitë me materiale arkivore të AIDSSH "Persekutimi komunist në zonën e Tepelenës"; simpozium shkencor mbi kuadrin historik dhe juridik të punës së detyruar, në përgatitje të konferencës mbi kampet e punës së detyruar; përpjekjet e koordinuara të institucioneve për ngritjen e Muzeut Kombëtar të Kampeve të Punës së Detyruar/të Memorialit; vizitë e Presidentit të Republikës së Shqipërisë në mjediset e kampit; ceremoni nderimi për të mbijetuarit e vuajtjes dhe ndarje dekoratash për "Merita të veçanta civile" të mbijetuarve të kampit; u realizua projekti "N'dritë", si bashkëpunim i AIDSSH me IPP, Harabel dhe MEMO, që përfshinte shfaqjen e pjesëve: "Sikur mama..."; "Shtrati dhomë"; "Dru me pre" - video-monolog bazuar në histori të vërteta; u shfaq instalacioni "Edhe Muret Kanë Veshë" dhe koncerti me grupet "Asgjë sikur dielli" e "3 Muskietierët", si triumf i jetës dhe dinjitetit njerëzor.
- Për të fituar nga përvoja më e mirë ndërkombëtare në fushën e kujtesës kolektive historike, AIDSSH me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë në datën 8-11/10/2018 kreu një vizitë studimore në Izrael. Gjatë vizitës, grupi i punës i AIDSSH u njoh me: a) përvojën e muzeut më të konsoliduar të kujtesës; b) përvojën për kërkimin shkencor dhe edukimin qytetar; c) punën e

departamentit të komunikimit. Shkëmbimi i përvojës mes dy institucioneve u shoqërua me shfaqjen e filmit dokumentar "Besa", që vë në qendër dinjitetin njerëzor dhe e lidh kujtesën me vlerat.

- Në ditën e parë të vitit akademik universitar 2018-2019, AIDSSH përuroi këndin e kujtesës së studiueses Sabiha Kasimati, në Muzeun e Shkencave të Natyrës që tashmë mban emrin e saj. Aktivitetet u zhvilluan në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, studiues e familjarë në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit. Këndi i Kujtesës "Sabiha Kasimati" u finalizua nga bashkëpunimi i një grupi ndërdisiplinor me historianë, biologë, arkivistë, gazetarë e kërkues shkencorë dhe një pjesë e të dhënave ekspozohen për herë të parë. Me realizimin e këndit informues në hyrje të Muzeut, AIDSSH përmbush një ndër detyrat e tij të informimit qytetar përmes kërkimit shkencor, në funksion të së vërtetës historike dhe përbaljes me të shkuarën. Pas një pune më shumë se njëvjeçare të institucionit, të bashkërenduar me projekte të shkencës, hedhjes dritë mbi të kaluarën dhe ridimensionimit të personaliteteve, u bë e mundur që Sabiha Kasimati t'i jepet një vend nderi në Muzeun që e ideoi, konceptoi, propozoi e themeloi, para se të dënohej dhe ekzekutohej brutalisht, për t'u braktisur në harresë dhjetërvjeçare. Kjo veprimtari u shoqërua edhe me shfaqjen e filmit dokumentar mbi jetën e Sabiha Kasimati.

Puna në të ardhmen

- Vijimi i punës për muzealizimin e kampit të punës në Tepelenë dhe kthimin e tij në një nga vendet e rëndësishme të kujtesës.
- Krijimi i ekspozitave të posaçme për disa figura të njohura me materialet arkivore të AIDSSH-së, duke nxitur studiuesit të kryejnë studimet e para për përndjekjen që ka ushtruar ndaj tyre regjimi komunist.
- Vazhdimi i punës me një kalendar veprimtarish të Ditëve të Kujtesës, për të komunikuar me rininë dhe publikun e gjerë përmes artit, komunikimit masiv dhe ekspozitave të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit me tematikë të caktuar.
- Vijimi i punës me botime studimesh për persona apo ngjarje të caktuara, si Kryengritja e Zhapokikës në rrethin e Tepelenës, që do t'i shërbejnë pasurimit të Muzeut të Kampit të Tepelenës.

ISH-KAMPI I INTERNIMIT, TEPELENË KTHIMI NË VENDKUJTESË

Shqiptarët kanë nevojë urgjente për zgjimin e ndërgjegjes, për vetëdijësimin mbi krimin komunist dhe pasojat serioze të tij

Çështja

Propaganda e madhe komuniste, fshehja e informacionit, ruajtja në sekretin më të madh, pamundësimi i njohjes së realitetit të dhunës së shtetit të diktaturës së proletariatit ka krijuar iluzione të shumta tek ajo pjesë e popullit që nuk vuajti nëpër burgje a internime. Vijimi i heshtjes edhe gjatë viteve të demokracisë dhe mosqartësimi i përmasave të asaj dhune ka lënë boshllëk të madh e po shoqërohet me procese regresive të tilla, si rilindje nostalgjsh për të kaluarën "e ndritur" socialiste, nderim i diktaturës, diktatorit dhe njerëzve që u shërbyen atyre, etj. Shqiptarët kanë nevojë urgjente për zgjimin e ndërgjegjes, për vetëdijësimin mbi krimin komunist dhe pasojat serioze të tij mbi popullin shqiptar, andaj u nevojitet të shohin me sytë e tyre dhe të përballen edhe me vende konkrete të kujtesës, të tilla si institucionet e burgimit apo të internimit për të dënuar të ndërgjegjes apo të dënuar pa asnjë faj, vetëm për shkak të lidhjeve familjare a miqësore.

me tela me gjemba, të cilat nuk kanë qenë fenomen i përhapur në Lindjen Komuniste dhe mund të krahasohet vetëm me gulagët sovjetikë.

- Ky vend është kampi tipik ku vuajtës janë njerëz krejtësisht të pafajshëm: burra të moshuar, gra, fëmijë.
- Kampi është tipik për shkallën sipërore të mizorisë komuniste, ku një e treta e të dënuarve ishin fëmijë, 1163; është tipik edhe për vdekjet masive të fëmijëve dhe zhdukjet e varreve të tyre.
- Ndërsa për kampe të tjera të tilla, si ai i Beratit, Krutës, Valiasit, Cërrikut, Shijakut, Porto-Palermos, Kuçovës, Kuçit të Vlorës, etj., nuk kanë mbetur objekte kujtese, për Kampin në Tepelenë këto ekzistojnë. Disa nga kazermet e kampit ruhen ende. Për më tepër, skicat e piktorit Lek Pervizi, i mbijetuar i këtij kampi, japin dëshmi për t'i rindërtuar dhe riorganizuar për qëllime muzeale, në të njëjtën mënyrë siç kanë qenë, mjediset ku strehoheshin të internuarit.



E kaluara e preksme në objektet dhe mjediset ku mijëra vetë vuajtën apo humbën jetën, humbën edhe varret e tyre, e kaluara e muzealizuar është një thirrje për mosharresë, për mosnënshtrim ndaj diktaturave.

Në sistemin e dëbim-internimeve, ish-kampi i internimit Tepelenë (këtej e tutje "Kampi") spikat për disa arsye:

- Ky kamp mbart mijëra histori të dhimbshme njerëzore. Për shkak të situatës ekstreme të jetës, ai është përmendur në mënyrë të posaçme nga qeveria amerikane në Kombet e Bashkuara në vitin 1955, si pjesë e ankesës së saj për shkeljen e të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe për përdorimin e punës së detyruar si ndëshkim.
- Pasqyron më së miri tipologjinë e kampeve të rrethuara

Roli i AIDSSH-së

AIDSSH e mbështet punën e vet dhe vijimësinë e projekteve të ndërmarra në parimet e rëndësishme të kujtesës, që e vënë memorien historike në themel të identitetit dhe trashëgimisë së individëve e bashkësive, si: paraqitja e këndvështrimeve të ndryshme; shmangia e përgjithësimave; trajtimi i figurave historike si individë; sigurimi i një baze origjinale historike; përdorimi i njohurive të nivelit akademik si burime, ku çdo përmbajtje duhet të ballafaqohet e të diskutohet me akademikë të njohur dhe të çertifikuar për njohuritë specifike e të duhura për këtë punë.



Presidenti i Republikës, Ilir Meta gjatë dorëzimit të titullit "Për merita të veçanta civile", znj. Gjelë Gjokola në Tepelenë



Vizitor duke u njohur me projektin për kthimin e ish-kampit të Tepelenës në Memorial



Gjatë aktivitetit për prezantimin e punës për Memorialin e Tepelenës



Gjatë aktivitetit për Memorialin e Tepelenës më 23 Gusht 2018

Mbështetur në këto parime, në kërkimin shkencor dhe përballjen profesionale të fakteve, AIDSSH ka ndërmarrë projekte ambicioze e komplekse, me fokus rishqyrtimin e historisë, rivlerësimin e saj, rehabilitimin e viktimave, rezistencën në personalitete e komunitete dhe inkurajon dialogun social, në emër të transparencës dhe konsolidimit të demokracisë.

Përmes punës së filluar për të ngritur një vend kujtese të kampeve të punës së detyruar në Tepelenë, AIDSSH synon të krijojë një model për të gjitha kampet e punës së detyruar në Shqipëri, ku e shkuara të shërbejë për reflektim e të mos përsëritet.

Brenda kuadrit ligjor mbi të cilin AIDSSH mbështet punën e vet, duke pasur në themel vlerat e transparencës, integritetit, bashkëpunimit, të mësuarit dhe angazhimit, po punohet për ndërgjegjësimin e publikut përmes të mësuarit të vazhdueshëm, si një mënyrë për të inkurajuar angazhimin demokratik.

AIDSSH është i hapur për bashkëpunim me të gjithë aktorët e faktorët, në mënyrë që Kampi në Tepelenë, si dëshmi e kampeve të punës së detyruar në diktaturë, të përfaqësojë një vend reflektimi për të rinjtë, studentët, qytetarët dhe të nderojë sakrificën e dinjitetin njerëzor të mijëra personave, burra, gra e fëmijë, që u keqtrajtuat në kampet e punës së detyruar në të gjithë vendin.

Arritje/ Projekti i muzealizimit të Kampit në Tepelenë

- Në funksion të veprimtarisë hulumtuese, me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit dhe për edukimin qytetar, me Vendimin nr. 54, datë 10.08.2017, AIDSSH nisi realizimin e Projektit të Kujtesës "Memoriali Kombëtar i Kampeve të Punës të Detyruar" dhe ngriti grupin e punës "Për kërkimin e dokumentacionit arkivor për kampin në Tepelenë dhe krijimin e një memoriali për përkujtimin e datës 30 gusht, si Dita Ndërkombëtare e të Zhdukurve", bazuar në ligjin nr. 45/2015 dhe

ligjin nr. 9154, dt. 06.11.2003 "Për arkivat", mbi përgatitjen dhe hapjen e ekspozitave dokumentare, si edhe në ligjin nr. 9802, datë 13.9.2007 "Për Ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare të OKB-së "Për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë".

- Projekti përmban rikthimin në identitet, si kamp dëbimi të një prej kapanoneve të kampit në Tepelenë, vendosjen e standave me dëshmi, fotografi dhe dëshmi arkivore për kampet e dëbim – internimit, dizenjimin, pozicionimin dhe mbjelljen e disa fidanëve (qiparisa) për përkujtimin e fëmijëve që kanë humbur jetën nga kushtet e vështira në Kampin në Tepelenë dhe janë pa një vendvarrim. Ndërtimi i këtij Memoriali shënon vetëm hapin e parë për transformimin e të gjithë kompleksit në një Muze të Kampeve të Punës së Detyruar të Diktaturës Komuniste.
- Projekti i kujtesës është përfshirë në programin qeverisës për vitet 2017-2021, në kapitullin kushtuar kulturës dhe edukimit përmes saj. Programi thekson: "Rrugët e Kujtesës" janë gjithashtu një itinerar unik i Shqipërisë, që do të vijojnë të nxjerrin në pah aspektin historik dhe edukativ të vendeve të ish-diktaturës, si Spaçi apo Tepelena, në vijim të projekteve tashmë të njohura muzeale të Kujtesës".
- Bashkia Tepelenë, në mbështetje të angazhimit të AIDSSH, e përcaktoi projektin e Memorialit Kombëtar të Kampeve të Punës së Detyruar si objekt prioritar për Zhvillimin e Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale për Artin dhe Kulturën për vitin 2018. Projekti mori mbështetjen e pushtetit vendor me Vendimin e Këshillit Bashkiak Tepelenë nr. 40, datë 30.11.2017 "Për miratimin e objekteve prioritare të investimeve për vitin 2018".
- AIDSSH ka firmosur disa marrëveshje bashkëpunimi me partnerë, të cilët ndihmojnë në mbledhjen e dokumenteve dhe të dhënave zyrtare, por edhe në ndërgjegjësimin qytetar dhe edukimin shoqëror, nëpërmjet rishqyrtimit të historisë dhe rivlerësimit të saj. Për mbledhjen e dokumenteve zyrtare që faktojnë periudhën e ekzistencës së Kampit në Tepelenë është bashkëpunuar me

Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, me Institutin e Integritetit të Përndjekurve Politikë, Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri.

- Projekti është mbështetur nga partnerë si PNUD, OSBE, institucione të tjera, publike vendore dhe qëndrore, akademike dhe të kërkimit shkencor. Në kuadër të projektit "Përkujtojmë, për të shëruar dhe parandaluar", krahas konceptualizimit, historisë dhe praktikave të punës së detyruar gjatë regjimit komunist përmes një qasjeje historiko-juridike, është punuar dhe për konceptimin e vendeve të kujtesës, si Kampi në Tepelenë.
- Në vijim të punës kërkimore shkencore, AIDSSH ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi edhe me Institutin e Historisë dhe Universitetin e Tiranës, për njohjen e thelluar të së shkuarës dhe trajtimin profesional të saj.
- Ministria e Kulturës mbështeti projektin e AIDSSH-së për një Memorial në kampin e dëbim-internimit në Tepelenë: dizenjimin, pozicionimin, mbjelljen e fidanëve (qiparisa) për përkujtimin e fëmijëve që kanë humbur jetën nga kushtet e vështira në Kampin në Tepelenë dhe janë pa vendvarrim.
- Ministria e Mbrojtjes iu bashkua punës së AIDSSH, duke hapur për publikun të gjithë mjedisin e Kampit në Tepelenë dhe ndihmoi me mjete materiale e burime njerëzore në sistemimin e tij, me qëllim kryerjen e aktivitetit në kuadër të Ditës Europiane të Viktimave të Sistemeve Totalitare.
- AIDSSH siguroi të dhëna të rëndësishme përmes Institutit të Integritetit të ish-të Përndjekurve Politikë, të tilla si lista me të dënuarit me punë të detyrueshme në kampin në Tepelenë dhe kategorizimin e tyre: gjithsej 3380 persona, nga të cilët 973 burra të moshuar, 1254 gra dhe 1163 fëmijë.
- Projekti i kujtesës "Memoriali Kombëtar i Kampeve të Punës të Detyruar" u prezantua publikisht në Tepelenë në 30 gusht 2017, nga arkitektë, në prani të përfaqësuesve të AIDSSH-së, Bashkisë Tepelenë, partnerëve ndërkombëtarë, të mbijetuarve dhe trashëgimtarëve

të tyre, qytetarëve të Tepelenës, historianëve e studentëve, përfaqësuesve të institucioneve publike dhe joqeveritare, organizatave kombëtare e ndërkombëtare dhe medias.

- Më 30 gusht 2017 u hodh hapi i parë për fillimin e punës për Memorialin, me mbjelljen e qiparisëve të parë që përkujtojnë të miturit e zhdukur.
- AIDSSH në 20 gusht 2018, në mjediset e institucionit, pranë Gardës së Republikës, ekspozoi materiale arkivore, dokumente të rezistencës antikomuniste, dhjetëra dosje të përndjekjes së Sigurimit të Shtetit ndaj faktorit antikomunist në zonën e Tepelenës dhe masat që pasuan, shumë prej të cilave, për herë të parë. Materialet në disa mijëra faqe u vunë në dispozicion të të interesuarve, studiues dhe kërkues shkencorë, ish-të përndjekur dhe familjarë të tyre, shoqëri civile dhe media, duke mundësuar njohjen me inventarët e plotë dhe më gjerë.
- U identifikuan personazhet kryesore të Kryengritjes së Zhapokikës në gusht të 1948 dhe dosjet hetimore gjyqësore, mes të cilëve ajo e Atë Gjergj Sulit, Baba Shefqet Mahmutit, Zenel Shehut e të tjerë.
- U ekspozuan treguesit alfabetikë që mbante Sigurimi i Shtetit për të përndjekurit në zonën e Tepelenës; statistika të të burgosurve të 1945 si dhe disa dosje formulare, si ajo e Selahudin Totos; dosje informative të të pushkatuarve, të të përndjekurve dhe statistika të detajuara të tyre; raporte të elementit antiparti, ku dokumentohet survejimi i personave të internuar; lista të Sigurimit të Shtetit me të arratisurit dhe të vrarët në kufi; raporte informative për banda diversantësh dhe dosjet e Sigurimit të Kampit të Bënçës.
- Për herë të parë u ekspozuan regjistrat e përpunimit të mbarë zonës së Tepelenës, si dhe dosjet voluminoze hetimore gjyqësore të grupit me të cilin u dënua poeti Trifon Xhagjika, ato të Neim Pashës e dhjetëra të tjera. AIDSSH kreu kërkim të thelluar mbi viktimat dhe të përndjekurit e kësaj zone nga periudha 1945-1968, në dokumente, indekse alfabetike dhe statistika. Të gjitha materialet e sipërpërmendura janë deklasifikuar.